



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE**  
**(Provim me zgjedhje për shkollat e mesme me drejtim të orientuar artistik)**

**DEGA: MUZIKË**

**LËNDA:**

**HISTORI MUZIKE**  
**ME ZGJEDHJE**

**VITI SHKOLLOR 2019 -2020**  
**KOORDINATORE: MAJLINDA HALA**

## I. HYRJE

Programi orientues për lëndën me zgjedhje “Histori muzike” përfshin njohuritë, konceptet dhe aftësitë më të rëndësishme të “Historisë së Muzikës” për shkollën e mesme me drejtim të orientuar artistik.

Programi orientues për provimin me zgjedhje “Histori muzike”, në Maturën Shtetërore për vitin shkollor 2019-2020, përbën një dokument të vlefshëm për shkollat e mesme me drejtim të orientuar artistik, dega “Muzikë”, për nxënësit e interesuar dhe për specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimin e Maturës Shtetërore.

Programi:

- Gjeneron informacionin e nevojshëm për mësuesit që japin lëndën “Histori muzike” në shkollat e mesme me drejtim të orientuar artistik, dega “Muzikë”, që do të përgatisin maturantët për provimin “Histori muzike”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Orienton nxënësit për materialet kyçe mësimore, *njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore*, që ata duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin “Histori muzike”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Përbën, gjithashtu, një *dokument zyrtar* që duhet zbatuar me korrektësi nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit “Histori muzike”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.

Programi orientues “Histori muzike” synon vlerësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve në këtë lëndë dhe është strukturuar në bazë të disa rubrikave që ndjekin dhe sqarojnë njëra-tjetrën.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes dhe korrektësi nga secili prej grupeve të interesuara, sidomos kujdes duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit “Histori muzike” si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore, **të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program.**

Vëmendje duhet të tregojnë këta specialistë edhe në lidhje me sigurimin e balancës midis përqindjes që zë secila temë studimi në këtë program me përqindjet që zënë këto tema në testin e

provimit. Përgatitja e nxënësve për provimin “Histori muzike” duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme, duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh. Nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, koncepteve të historisë së artit dhe aftësive të përcaktuara në program. Për të arritur këtë, herë-herë ata duhet t’u rikthehen dhe çështjeve të ndryshme, të cilat nuk janë parashikuar në program, por që përmbajnë informacion bazë për të përvetësuar materialin e zgjedhur për provim.

## II. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues i lëndës me zgjedhje “Histori muzike” për provimin e Maturës Shtetërore, bazohet në parimin se të zotërosh njohuri artistike do të thotë të jesh në gjendje t’i zbatosh ato:

- në tematika të ndryshme të vetë lëndës “Histori muzike”;
- në situata të jetës së përditshme.

Programi orientues për përgatitjen e provimit me zgjedhje të lëndës “Histori muzike”, është mbështetur në programet e lëndës “Histori muzike” klasat 10-12 të;

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi përmban *strukturën e testit* në të cilën tematikat si dhe pesha e tyre.

Programi përmban rubrikën *e njohurive dhe rezultateve të të nxënësve* ku përcaktohen njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore për çdo tematikë të lëndës “Histori muzike”.

## III. STRUKTURA E TESTIT

Një nga aspektet më të rëndësishme në lëndën “Histori muzike” është zhvillimi i njohurive artistike në njohjen, gjykimin dhe vlerësimin e muzikës në përgjithësi, ndikimin e saj në jetën kulturore, shkencore, politike, artistike të vendeve ku është krijuar, dhe vlerësimin e veprave të përfaqësuesve të ndryshëm duke evidentuar dhe analizuar karakteristikat dhe risitë e çdo muzikanti.

Për secilën tematikë është **paraqitur pesha që zë secila prej tyre kundrejt orëve totale** të lëndës së Histori arti përgjatë viteve të shkollimit në zhvillimin e njohurive dhe rezultateve të të nxënësve që duhet të demonstrojnë nxënësi në përmbushjen e njohurive artistike. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja e testit duhet të zhvillohet në këtë renditje.

**Në përgatitjen për përmbushjen e këtij programi orientues do të përdoren programet e**

lëndës Muzikë dhe literatura dhe tekstet me të cilat këto shkolla zhvillojnë studimin e kësaj lënde.

Nr	Tematika	Pesha	Përmbajtja sipas tematikave
1.	<b>Kultura muzikore në Mesjetë</b>	5 %	<p><b>Kultura muzikore në Mesjetë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- muzika kishtare,</li> <li>- koralit gregorian,</li> <li>- shkrimi muzikor.</li> </ul> <p><b>Muzika bizantine</b></p>
2.	<b>Kultura muzikore në Rilindje</b>	8%	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kultura muzikore në Rilindje</b></li> </ul> <p>muzikën vokale: opera</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- opera në Itali</li> <li>- opera në Francë</li> <li>- opera në Angli</li> <li>- opera në Gjermani</li> </ul> <p>muzika instrumentale në shekullin XVII</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- muzika për organo</li> <li>- muzika për klavicembal</li> <li>- muzika për violinë</li> <li>- muzika për ansambëlinstrumental</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompozitorë:</b></li> <li>- A. Vivaldi</li> <li>- A. Koreli</li> </ul>
3.	<b>Kultura muzikore në</b>	10%	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kultura muzikore në Barok - paraklasike</b></li> <li>- Stili polifonik – vepra vokale, instrumentale dhe orkestrale.</li> <li>- Opera bufë dhe opera seria – Itali.</li> </ul>

	<b>Barok</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Opera balet – Francë.</li> <li>- Reforma e Glukut</li> <li>• <b>Kompozitorë:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- J.S. Bah,</li> <li>- Zh. F. Hendel,</li> <li>-K.V. Gluk.</li> </ul> </li> </ul>
4.	<b>Kultura muzikore në Klasicizëm</b>	25 %	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kultura muzikore në Klasicizëm</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Klasicizmi vjenez</li> <li>- Lindja e sonatës dhe simfonisë klasike</li> <li>- Risitë në opera</li> <li>- Risitë në muzikën instrumentale dhe simfonike</li> <li>- Sonata</li> <li>- Simfonia</li> <li>- Uvertura</li> </ul> </li> <li>• <b>Kompozitorë:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- F. J. Hajden,</li> <li>- A. Moxart,</li> <li>- L. V. Bethoven.</li> </ul> </li> </ul>
5.	<b>Kultura muzikore në Romantizëm</b>	37 %	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kultura muzikore në Romantizëm</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rregullat e stilit muzikor romantik,</li> <li>- stili i muzikës romantike nga stilet para klasike dhe klasike.</li> <li>- krijimi i shkollave kombëtare, shek. XIX</li> <li>- grupi i të pestëve,</li> <li>- Verizmi - opera italiane shek XX</li> <li>- Neoklasicizmi,</li> <li>- llojet dhe gjinitë e muzikës romantike: <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>instrumentale</i>,</li> </ul> </li> </ul> </li> </ul>

			<p><i>vokale,</i> <i>muzika e dhomës,</i> <i>simfonike,</i> <i>vokalo - simfonike dhe</i> <i>muzika me program.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kompozitorë sipas periudhave të marra në studim:</b></li> </ul> <p>K.M.Veber F.Shubert F.Shopen F.Mendelson V.Belini, XH.Rosini, Donixeti N.Paganini H.Berlioz, F. List, J.Brams, Xh.Verdi, Sh. Guno, Zh.Bize R.Vagner, E Grig, B. Smetana, A. Dvorzhak, M.Glinka, Musorgski, Borodin, Korsakov, Alexander Skriabin P.Çajkovski</p>
6.	<b>Kultura muzikore shek. XX në</b>	10 %	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kultura muzikore në shek. XX</b></li> <li>- krijimin modern, me thyerje të formave tradicionale dhe rregullave të kompozimit, me muzikën atonale,</li> <li>- stile të reja muzikore: verizëm, impresionizëm, ekspresionizëm, neoklasicizëm),</li> <li>• <b>Kompozitorë:</b></li> </ul> <p>Xh. Puçini, J. Sibelius, B. Bartok Igor Stravinski</p>

7.	<b>Kultura muzikore shqiptare</b>	5 %	<p><b>Kultura muzikore shqiptare</b></p> <p>Kënga dhe romanca shqiptare</p> <p>Gjinitë e mëdha të muzikës vokale shqiptare:  opera e parë shqiptare “Mrika”;  “Lulja e Kujtimit”;  “Skënderbeu” .</p> <p>Muzika e baletëve shqiptare:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• baleti i parë shqiptar - “Halili dhe Hajria”;</li> <li>• baletet “Delina”;</li> <li>• “Cuca e maleve“.</li> </ul> <p>Muzika instrumentale shqiptare - zhvillimi dhe karakteristikat e përgjithshme të saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Miniatura.</li> <li>• Balada.</li> <li>• Sonata.</li> <li>• Muzika e dhomës.</li> <li>• Koncertet instrumentale.</li> </ul> <p>Muzika simfonike shqiptare:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rapsoditë.</li> <li>• Uvertura.</li> <li>• Suita.</li> <li>• Vallja simfonike.</li> </ul> <p>Poemi simfonik .  Simfonitë shqiptare.</p> <p><b>Kompozitorë:</b></p> <p>Çesk Zadeja, T. Harapi, Aleksander Peçi, Tish Daija, Prenk Jakova, Pjetër Gaci, Feim Ibrahim, Nikolla</p>
----	-----------------------------------	-----	--

			Zoraqi, Shpëtim Kushta, Thoma Gaqi, Kristo Kono, etj.
--	--	--	---

#### IV. TABELA E REZULTATEVE TË TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË

Për secilën tematikë, më poshtë paraqiten njohuritë dhe rezultatet e të nxënit që duhet të demonstrojë nxënësi për të përmbushur kompetencat artistike nëpërmjet lëndës “Histori muzike”. Megjithëse njohuritë përcaktohen për secilën tematikë ato trajtohen të integruara dhe të lidhura me njëra - tjetrën.

##### TEMATIKA: Kultura muzikore në Mesjetë

Njohuritë muzikore	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave muzikore
<b>Kultura muzikore në Mesjetë</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin zhvillimin e kulturës muzikore në Mesjetë.</li> <li>- shpjegojnë ç’përfaqëson korali gregorian dhe çfarë veçorish e karakterizojnë atë.</li> <li>- përshkruajnë faktorët që mundësuan lulëzimin e muzikës laike në Mesjetë.</li> <li>- përcaktojnë tiparet e muzikës polifonike mesjetare.</li> <li>- analizojnë faktorët që çuan në lindjen e shkrimit muzikor.</li> <li>- njohin përfaqësuesit e muzikës së kësaj periudhe.</li> </ul>

##### TEMATIKA: Kultura muzikore në Rilindje

Njohuritë muzikore	Rezultatet e të nxënit për realizimin e
--------------------	---

	<b>kompetencave muzikore</b>
<b>Kultura muzikore në Rilindje</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njihen me zhvillimin e muzikës në periudhën e Rilindjes.</li> <li>- shpjegojnë zhvillimin e polifonisë dhe të formave të reja muzikore vokale laike.</li> <li>- përshkruajnë veçoritë e gjinive kryesore të muzikës vokale: madrigali, oratorio, psalmet etj.</li> <li>- studiojnë muzikën e shkollave polifonike dhe përfaqësuesit e tyre.</li> <li>- përcaktojnë instrumentet muzikore më të përdorura gjatë periudhës së Rilindjes.</li> <li>- njohin përfaqësuesit dhe të analizojnë veprat kryesore muzikore të kompozitorëve të Rilindjes.</li> </ul>

### **TEMATIKA: Kultura muzikore në Barok**

<b>Njohuritë muzikore</b>	<b>Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave muzikore</b>
<b>Kultura muzikore në Barok</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rendisin disa tipare shoqërore -historike të kësaj periudhe.</li> <li>- njihen me lindjen e operës së shek. XVIII.</li> <li>- përshkruajnë zhvillimin e operës në Europë gjatë shek. XVIII.</li> <li>- njihen me zhvillimin e muzikës barok dhe muzikës instrumentale.</li> <li>- shpjegojnë elementet muzikore të stilit barok në</li> </ul>

	<p>instrumentet me tastierë dhe instrumentet me harqe.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruajnë lindjen e muzikës për ansambël instrumental dhe për violinë solo.</li> <li>- klasifikojnë në vepra dhe autorë llojet e stilit barok (monodi, homofoni, polifoni).</li> <li>- përcaktojnë disa nga gjinitë kryesore muzikore të kësaj periudhe.</li> <li>- njohin përfaqësuesit kryesorë dhe të analizojnë veprat kryesore muzikore të kompozitorëve të periudhës barok.</li> </ul>
--	---

#### **TEMATIKA: Kultura muzikore në Klasicizëm**

<b>Njohuritë muzikore</b>	<b>Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave muzikore</b>
<b>Kultura muzikore në Klasicizëm</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rendisin disa tipare shoqërore -historike të kësaj periudhe.</li> <li>- njohin disa nga rregullat e stilit muzikor klasik.</li> <li>- dallojnë stilin e muzikës klasike nga stilet e tjera muzikore.</li> <li>- përcaktojnë llojet dhe gjinitë e muzikës klasike.</li> <li>- njohin zhvillimin e mëtejshëm të muzikës instrumentale, simfonike dhe vokale.</li> <li>- njohin përfaqësuesit dhe të analizojnë veprat kryesore muzikore të kompozitorëve klasikë.</li> </ul>

#### **TEMATIKA: Kultura muzikore në Romantizëm**

<b>Njohuritë muzikore</b>	<b>Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave muzikore</b>

<p><b>Kultura muzikore në Romantizëm</b></p>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallojnë disa nga tiparet shoqërore -historike të kësaj periudhe.</li> <li>- njohin zhvillimin e mëtejshëm të muzikës instrumentale, simfonike, vokale dhe të muzikës me program.</li> <li>- njohin disa nga rregullat e stilit muzikor romantik.</li> <li>- dallojnë stilin e muzikës romantike nga stilet para klasike dhe klasike.</li> <li>- përcaktojnë llojet dhe gjinitë e muzikës romantike, si: <i>instrumentale, vokale, muzika e dhomës, simfonike, vokalo - simfonike dhe muzikës simfonike me program.</i></li> <li>- njohin përfaqësuesit dhe të analizojnë veprat kryesore muzikore të kompozitorëve romantikë.</li> </ul>
--	---

**TEMATIKA: Kultura muzikore në shek. XX**

Njohuritë muzikore	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave muzikore
<p><b>Kultura muzikore në shek. XX</b></p>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallojnë tiparet shoqërore - historike të kësaj periudhe.</li> <li>- njohin zhvillimin e mëtejshëm të muzikës instrumentale, vokale, simfonike, dhe të muzikës me program.</li> <li>- përcaktojnë stilet muzikore të periudhës.</li> <li>- dallojnë elementet teknikë, si: <i>harmonia, meloritmika, orkestracioni.</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin llojet muzikore të shek. XIX - XX dhe bashkëveprimin midis tyre;</li> <li>- përshkruajnë zhvillimin teknologjik në muzikë.</li> <li>- njohin përfaqësuesit dhe veprat kryesore muzikore të kompozitorëve të shek. XX.</li> </ul>
--	--

### TEMATIKA: Kultura muzikore shqiptare

Njohuritë muzikore	Rezultatet e të nxënit për realizimin e kompetencave muzikore
<b>Kultura muzikore shqiptare</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcaktojnë periudhat e zhvillimit të muzikës shqiptare.</li> <li>- dallojnë tiparet kombëtare të muzikës shqiptare.</li> <li>- njohin zhvillimin e muzikës <i>instrumentale, simfonike, vokale dhe të muzikës simfonike</i>.</li> <li>- njohin disa nga rregullat muzikore të stilit muzikor shqiptar.</li> <li>- përcaktojnë llojet dhe gjinitë e muzikës shqiptare: <i>vokalo -instrumentale, muzikës së dhomës, simfonike, vokale simfonike dhe muzikës simfonike: rapsodia, vallja simfonike, uvertura etj.</i></li> <li>- njohin veprat kryesore muzikore të kompozitorëve shqiptarë.</li> </ul>